



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 22 datë 24.03.2021

**Dhënie ndihme të menjëhershme financiare familjeve që janë dëmtuar banesws sw
z.Zef Pal Huba si pasoje e reshjeve të periudhës 07.01.2021-11.01.2021**

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.80 dt.24.12.2020 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2021”.si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.2 dt.12.02.2021, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare të menjëhershme për shtetasin **Zef Pal Huba** banorë i Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës:

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

- 1. Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për shtetasin **Zef Pal Huba** banorë i Njesisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **91.900 lekë** (Nëntëdhjete e një mijë e nënteqind) për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij.
- 2. Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
- 3. Burimi i financimit :**Fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.80 dt.24.12.2020 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

4. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Mark Bishe

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Adrian Çelepi

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 29.03.2021

